



Letër Këshilluese 2016 – 01

Gusht 2016

ICAAP – PROCESI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË MJAFTUESHMËRISË
SË KAPITALIT

ICAAP – PROCESI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË MJAFTUESHMËRISË
SË KAPITALIT

QËLLIMI

Në funksion të adaptimit të Standardeve të Basel-it për Kapital, në kuadër të Projektit për Implementimin e Basel-it, si dhe për harmonizimin e mëtejme të kornizës rregullative të mbikëqyrjes së bankave me Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian të cilat adresojnë këtë fushë, BQK ka përgatitur këtë Letër Këshilluese e cila ka për qëllim iniciimin e implementimit të ICAAP – procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat që operojnë në Kosovë.

Në këtë kontest kjo Letër Këshilluese duhet të konsiderohet si udhëzues për bankat të cilat duhet të fillojnë përgatitjet e nevojshme për implementimin e kërkesave të ICAAP në mënyrë që të adaptojnë proceset e tyre të brendshme të nevojshme për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit varësisht nga struktura e bilancit të tyre dhe strategjitë e parashikuara biznese. Kjo letër këshilluese përmban parimet themelore të ICAAP të cilat BQK i konsideron si eseciale për fillimin e përgatitjeve për implementim. Njëkohësisht, BQK pret që bankat të fillojnë rishikimin dhe zhvillimin e politikave dhe sistemeve të tyre të brendshme në mënyrë që të përgatiten për implementimin e plotë të një procesi adekuat për vlerësimin e brendshëm të nevojave të kapitalit, konkretisht implementimin e ICAAP-it, si pjesë kyçe e kërkesave të Shtyllës së Dytë të Standardeve të Basel-it për Kapital.

ICAAP – Procesi i Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë
së Kapitalit

Letër këshilluese për bankat që operojnë në Republikën e Kosovës

Përmbajtja

1. Hyrje

1.1. Definicioni

1.1.1. ICAAP-i

1.1.2. Rreziqet

1.1.2.1. Identifikimi i Rrezikut

1.1.2.2. Matja (Kuantifikimi) e Rrezikut

1.1.2.3. Agregimi i Rrezikut

1.1.2.4. Mbulueshmëria e Rrezikut me Kapital

1.1.2.5. Kapaciteti Absorbues i Rrezikut

1.2. Kërkesat për ICAAP

1.2.1. Adekuatshmëria e Institucioneve

1.2.2. Korniza e Menaxhimit të Rrezikut

1.2.2.1. Koncentrimi i Rreziqeve

1.2.2.2. Kontrolli/Menaxhimi i Rrezikut

1.2.2.3. Rreziku Kreditor

1.2.2.4. Rreziku i Normës së Interesit

1.2.2.5. Rreziku i Likuiditetit

1.2.2.6. Rreziku Operacional

1.2.2.7. Rreziku Strategjik

1.2.2.8. Rreziku Shtesë

1.2.3. Korniza e Menaxhimit të Kapitalit

1.2.4. Dokumentimi i ICAAP-it

1.3. Dizajnimi i ICAAP-it

1.4. Metodologjia

1.4.1. Kërkesat e Kapitalit sipas Shtyllës I

1.4.2. Qasja e Strukturuar

1.4.3. Qasja për shpërndarjen e marrjes së rrezikut

2. Udhëzimet e ICAAP-it

3. Roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

1. Hyrje

Kjo Letër Këshilluese ofron rekomandime për bankat që operojnë në Republikën e Kosovës lidhur me mënyrën e qasjes ndaj Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. ICAAP). Procesi ICAAP synon të iniciojë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) konceptin e vlerësimit të kapitalit sipas Shtyllës së II-të të Bazel-it, i cili ka filluar në Marrëveshjen e Bazel-it në vitin 2006. ICAAP si koncept ka për qëllim të ndihmojë bankat në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në mënyrë të përshtatshme dhe siç kërkohet për të implementuar procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit. Rekomandimet e ofruara në këtë Letër nuk paragjykojnë metodologjitë e brendshme të bankave me të cilat ato i vlerësojnë rreziqet. Ky dokument ka të bëjë vetëm me qështjet të cilat lidhen me mënyrën se si të përcaktohet kapitali i brendshëm i nevojshëm sipas Shtyllës së II-të të Standardeve të Bazel-it për Kapital.

Në përgjithësi, bankat tashmë kanë të dizajnuara strategjitë e tyre për menaxhimin e rreziqeve përkatëse. Menaxhimi i këtyre rreziqeve zakonisht bëhet në proporcion me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve të vetëvetishme në modelin biznesor të bankës dhe aktivitetet e institucionit, si dhe ndikimin aktual të vendimeve në menaxhimin e rreziqeve. Secila bankë, qoftë në mënyrë formale apo joformale, ndjekë principe dhe procese specifike për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve të saj. Bashkë me konceptimin/projektimin e principeve dhe proceseve adekuate për menaxhimin e rreziqeve në mënyrë më të standardizuar dhe transparente, bankat mund të zvogëlojnë rreziqet që mund të rrjedhin nga aktivitetet e bankës.

Përveç metodave të ndryshme të implementuara (nga metologjitë rregullatore apo të brendshme) për llogaritjen e kërkesave minimale për kapital dhe shpalojsen e rregullt publike, një proces i standardizuar i vlerësimit të brendshëm të kërkesave kapitale është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm për monitorimin efektiv dhe menaxhimin e një game rreziqesh, ndaj të cilave bankat ose janë të ekspozuara ose mund të ekspozohen gjatë operacioneve biznesore.

Megjithëse implementimi i këtyre kërkesave mund të sfidojë bankat, megjithatë është detyrë e bankave të themelojnë një sistem të brendshëm dhe funksional, i cili gjithashtu përfshinë proceduara të standardizuara dhe metodologji që sigurojnë se bankat kanë kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet materiale në periudhë afatgjate. Në thelb, kjo Letër kërkon nga bankat të integrojnë një qasje parashikuese në procesin e menaxhimit të rreziqeve.

Në këtë drejtim, bankat mund të zhvillojnë metoda të brendshme që inkorporojnë një shumëllojshmëri elementesh cilësore dhe sasiore, të cilat do të duhej të kufizojnë ekspozimin ndaj rreziqeve dhe të foromojnë bazën e një përmirësimi sistematik të profilit të rrezikut të tyre. Bankat duhet të tregojnë përshtatshmërinë dhe integritetin e duhur të ICAAP-it të përdorur gjatë dialogut konstruktiv dhe të vazhdueshëm me BQK-në. Ky dialog duhet të sigurojë që BQK-ja ka vlerësuar saktësinë e rezultateve të pranuar (nga procesi ICAAP prej bankave) dhe ka marrë masat e nevojshme mbikëqyrëse në rastet kur janë paraqitur mangësi në to.

Qasjet ndaj ICAAP-it të përshkruara në këtë Letër Këshilluese nuk janë detyrimore, meqë bankat mund të përdorin edhe metoda tjera në krijimin dhe zbatimin e ICAAP-it. Rekomandimet e nënvizuara, në radhë të parë përfaqësojnë udhëzim mbikëqyrës, prej së cilave bankat mund krijojnë ide se si t'i qasen procesit të ICAAP-it, i cili bazohet në Shtyllën e II-të të Standardeve të Bazelit për Kapital.

Kjo Letër e përgatitur nga BQK-ja ka për qëllim vetëm ofrimin e sugjerimeve (këshillave), të cilat mund të jenë të dobishme për bankat në dizajnimin ICAAP-it të tyre. Sipas Parimit 1 të Shtyllës II të Kornizës së Bazelit për Kapital, bankat duhet të kenë një proces për vlerësimin e përgjithshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit që përkon me profilin e rrezikut dhe strategjinë për ruajtjen e niveleve të kapitalit. Për më tepër, dizajnimi i procesit ICAAP në radhë të parë duhet të jetë në interesin e vetë bankës (dhe në interes të grupeve të interesit të lidhur me bankën në një mënyrë apo tjetër). Pavarësisht se interesat e grupeve të veçanta jo gjithmonë përkrijnë me ato të bankës, të gjithë ndajnë interesin e përbashkët se banka nuk duhet të marrë rreziqe të tilla (të nivelit apo llojit) që mund të rrezikojnë mbijetesën/ekzistencën e saj.

Prandaj, qëllimi kryesor i ICAAP-it është krijimi i profilit të rrezikut të bankës, si dhe identifikimi i hershëm i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që mund të ndikojnë negativisht në performancën e saj.

Qëllimi i kësaj Letre Këshilluese të përpiluar nga BQK lidhur me procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit është **të informojë bankat lidhur me pritjet e mbikëqyrjes rreth krijimit të një kornize të standardizuar për themelimin dhe zbatimin e ICAAP-it, përfshirë edhe raportimin në BQK si pjesë e rëndësishme për të siguruar një sistem bankar të shëndetshëm.**

1.1. Definicioni

Procesi ICAAP dhe Rreziqet do të definoohen në mënyrë më të detajuar në pjesët në vijim (në kontekst të proceve për identifikimin, matjen dhe përmbledhjen e rreziqeve, dhe llogaritjen e kapitalit të brendshëm dhe kapacitetit absorbues ndaj rrezikut).

1.1.1. ICAAP-i

Procesi i Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit përshkruan dhe përcakton rreziqet materiale ndaj të cilave banka është e ekspozuar ose mund të ekspozohet. Varësisht prej mënyrës së themelimit të ICAAP-it, një bankë llogaritet në mënyrë individuale kërkesat e brendshme për kapital për rreziqet materiale përkatëse dhe të përgjithshme dhe përcakton kapacitetin e saj absorbues ndaj rreziqeve. Gjatë përcaktimit të kapacitetit absorbues ndaj rreziqeve, banka definton nivelin e rreziqeve materiale përkatëse që është në gjendje të marrë, ndërkohë që siguron kapital të mjaftueshëm për mbulimin e këtyre rreziqeve. Ky ushtrim siguron edhe një mundësi për një analizë kritike ndaj sasisë së rrezikut që është i arsyeshëm për të marrë nga banka në relacion me mundësitë dhe kërcënimet përkatëse.

Një bankë duhet të demonstrojë se vlerësimi i brendshëm i kapitalit është gjithëpërfshirës dhe adekuat ndaj natyrës së rreziqeve të mundshme nga aktiviteti biznesor dhe ambienti operues. Prandaj, edhe vetë korniza me të cilën banka zhvillon procesin ICAAP pritet të jetë e bazuar në rrezik. Gjithashtu, duhet të ceket se ICAAP-

i duhet të jetë i orientuar si ndaj elementeve sasiore të menaxhimit të rreziqeve (si p.sh. përlllogaritja e kërkesave të brendshme për kapital) ashtu edhe ndaj elementeve cilësore, me qëllim të përforcimit të ambientit të brendshëm të bankës. Për shembull, banka mund të argumentojë me mbikëqyrësit e BQK-së se kërkesat e brendshme për kapital në lidhje me një rrezik individual ndaj të cilit ekspozohet janë më të ulëta, si rezultat i një ambienti të kualitetit të lartë të kontrollit të brendshëm në bazë të cilit në mënyrë efektive mund të menaxhojë dhe zvogëlojë rrezikun e tillë. Prandaj, kjo Letër Këshilluese vë theksin në rëndësinë e planifikimit të kapitalit dhe rënësinë e menaxhimit të tij, duke përfshirë këtu edhe aspektin cilësor të menaxhimit të rrezikut.

Pjesë e rëndësishme e ICAAP-it është identifikimi i rrezikut, si pjesë integrale e biznesit bankar. Ndryshimi i vazhdueshëm në kushtet tregjet financiare dhe ekonomike kërkon që rreziqet të identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë sistematike. Kjo qasje duhet të bazohet në metoda funksionale dhe efektive që i mundësojnë bankës identifikim efikas, vlerësim, monitorim dhe menaxhim të secilit rrezik individual. Prandaj, në këtë kontekst, zbatimi dhe përpilimi i ICAAP-it nuk duhet të shihet vetëm si një detyrë që përmbushë pritjet e Mbikëqyrjes, por gjithashtu edhe si një mbështetje që ofron informacion shtesë për grupet e interesit të lidhura me bankën. Implementimi i ICAAP-it duhet të sigurojë edhe një profil adekuat për secilin rrezik individual në mënyrë që faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që mund të afektojnë performancën e bankës të identifikohen sa më herët.

Zbatimi i ICAAP-it duhet të ndahet në dy hapa përkatëse nga bankat. Hapi i parë konsiston në identifikimin e sasisë së rrezikut i cili është i arsyeshëm për institucionin lidhur me profilin e biznesit dhe strategjinë, e njohur si apetiti i bankës për rrezik. Në hapin e dytë, bankat duhet të përcaktojnë kapacitetin e absorbimit të rrezikut si dhe të identifikojnë pozicionet me rrezik të cilat janë në gjendje t'i mbulojnë brenda këtij kapaciteti absorbues.

1.1.2 Rreziqet

ICAAP-i duhet të jetë pjesë e kornizës menaxhuese të rrezikut gjithëpërfshirës dhe atij individual. BQK-ja parashikon që këto procese të menaxhimit të rrezikut dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të jenë konsistente dhe të lidhura ngushtë me

strategjitë e biznesit apo planifikimit, përfshirë këtu edhe pjesën operative të bankës. Informacioni që i ofrohet BQK-së nga bankat lidhur me apetitin e rrezikut dhe menaxhimin e këtij rreziku duhet të listojë të gjitha rreziqet materiale të bankës. Të gjitha bankat përkatëse janë përgjegjëse për definimin e proceseve për menaxhimin e rreziqeve dhe sistemeve të cilat janë të përshtatshme për biznesin individual dhe profilin e rrezikut të tyre.

Si orientim për specifikimin fillestar të të profilit të rrezikut të bankës mund të jenë të dobishëm indikatorët si: madhësia e bankës, niveli i rrezikut apo kompleksiteti i transaksioneve (përfshirë transaksionet mes grupeve), shkalla e aktiviteteve biznesore dhe rëndësia e tregjeve apo transaksioneve të reja (p.sh. ekspozimet ndërkombëtare).

1.1.2.1 Identifikimi i rrezikut

Identifikimi i rrezikut përfaqëson fazën fillestare dhe një nga fazat më të rëndësishme në procesin e menaxhimit të rrezikut, i cili duhet të regjistrojë të gjitha ekspozimet ndaj rreziqeve materiale me të cilat banka ballafaqohet që mund të afektojnë targetet financiare. Ky hap është mëse i rëndësishëm për të vendosur bazat për pjesën e mbetur të procesit të menaxhimit të rrezikut për banka në mënyrë që të kontrollojnë rreziqet e identifikuar. Gjatë procesit të identifikimit të rreziqeve, banka duhet të përcaktojë të dhënat dhe burimin e të dhënave, meqë janë të nevojshme për matjen e pozicionit të rrezikut. Ky proces gjithashtu duhet të identifikojë ndryshimet në rreziqet ekzistuese dhe shfaqjen e rreziqeve të reja, duke përfshirë rreziqet që dalin nga fillimi i aktiviteteve të reja të biznesit ose produkteve të reja.

1.1.2.2 Matja (Kuantifikimi) e Rrezikut

Procesi i menaxhimit të rrezikut sipas ICAAP-it duhet të mbulojë në mënyrë të detajuar secilin rrezik në terma sasiorë. Kjo detyrë është e nevojshme për të krijuar një bazë objektive për një proces të përgjithshëm të vendimmarrjes në bankë dhe është veçanërisht e rëndësishme për bordin dhe mbikëqyrjen e lartë të bankës. Matja e rreziqeve siguron që banka mund të bëjë deklarime të qarta rreth kapacitetit absorbues të rreziqeve të saj si dhe vlerësimin e monitorimit të rreziqeve në kuadër të ICAAP-it.

1.1.2.3 Agregimi i Rreziqeve

Rreziqet individuale të bankës duhet të agregohen në mënyrë që të përcaktohet sasia e përgjithshme e rrezikut sipas ICAAP-it. Gjithashtu, është me rëndësi të sigurohet se asnjë rrezik material nuk është lënë anash apo nuk është lënë pa u përfshirë plotësisht, ashtu sikurse është e rëndësishme që mos të ketë përsëritje të rreziqeve. Bankave që janë më komplekse dhe më të sofistikuara u kërkohet një proces agregimi më adekuat, mepërgjegjësi qeverisëse si dhe të sigurojnë cilësi të të dhënave adekuate. Prandaj, është e nevojshme që banka të dokumentojë mirë dhe në mënyrë të plotë procesin e agregimit të rreziqeve për të siguruar një perspektivë të përgjithshme lidhur me supozimet e përdorura rreth ndërvarësië midis rreziqeve individuale.

1.1.2.4 Kapitali për Mbulimin e Rreziqeve

Nga bankat kërkohet që vazhdimisht të kuantifikojnë mbulueshmërinë e rreziqeve, e cila mbulueshmëri mund të pësojë ndryshime, varësisht nga fitimet e bankës gjatë ciklit të vitit biznesor të bankës. Në raste të veçanta, BQK mund të kërkojë nga bankat të injektojnë fonde shtesë në rastet kur mbulueshmëria e rreziqeve është joadekuate, kur sistemi i menaxhimit të rrezikut është joadekuat apo kur priten efekte negative nga faktorët e jashtëm (p.sh. ambienti makroekonomik).

1.1.2.5 Kapaciteti i Absorbues i Rrezikut

Kapaciteti Absorbues i Rrezikut përfaqëson vlerën maksimale të rrezikut që një bankë është në gjendje të marrë duke u bazuar në bazën e kapitalit të saj, menaxhimin e rreziqeve dhe masave kontrolluese, si dhe duke marrë parasysh edhe kufizimet rregullatore. Banka duhet të vlerësojë Kapacitetin e vet Absorbues të Rrezikut në kontekst të nivelit të rreziqeve materiale, përfshirë këtu edhe nivelin e agreguar të këtyre rreziqeve që është në gjendje ta mbajë, veçanërisht duke marrë parasysh mjaftueshmërinë e kapitalit për të mbuluar rreziqet e tilla dhe masat tjera adekuate për menaxhimin e tyre (me fjalë tjera, masat kualitative). Gjithashtu, secila bankë duhet të analizojë në mënyrë kritike profilin e saj të rrezikut sa i përket arsyeshmërisë si dhe lidhur me mundësitë dhe kërcënimet përkatëse. Profili i rrezikut të bankës duhet të

jetë i detajuar, i përditësuar në baza të rregullta, dhe transparent për t'u siguruar se vlerësimi i kapacitetit absorbues të rrezikut është transparent dhe i duhur.

1.2 Kërkesat për ICAAP

Bashkë me futjen e standardeve të kapitalit, një sërë kërkesash minimale rreth procesit ICAAP janë konsideruar të domosdoshme. Kërkesat për ICAAP përfshijnë proceset për vlerësimin e rreziqeve që shfaqen nga aktivitetet e bankës dhe duhet të sigurojnë që kapitali i mbajtur është i mjaftueshëm në raport me profilin e rrezikut të bankës. Kërkesat që dalin nga ICAAP gjithashtu përfshijnë idenë rreth mbajtjes strategjike të mjaftueshmërisë së kapitalit në afat të gjatë duke vendosur objektivat për kapital në përputhshmëri me profilin e rrezikut, apetitin për rrezik dhe kërkesat minimale për kapital të bankës.

1.2.1 Proporcionaliteti

Çdo bankë duhet të sigurohet se zbatimi i ICAAP-it është gjithpërfshirës dhe proporcional me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve të vetëvetishme në modelin biznesor dhe aktivitetet e bankës. Domethënë, secili ICAAP-it duhet t'i përshtatet karakteristikave individuale të bankës. Bankat me strukturë më komplekse duhet t'i qasen këtij procesi në mënyrë më të sofistikuar dhe në proporcion me natyrën e proceseve të tyre. Nga anën tjetër, bankat më pak komplekse, që kanë strukturë më të thjeshtë të biznesit mund të përdorin një qasje më të thjeshtësuar, e cila do t'i përshtatej më mirë profilit individual të biznesit. ICAAP duhet të përgatitet nga bankat e licencuara në BQK dhe që operojnë në Republikën e Kosovës. Degët e bankave të huaja mund të përdorin këtë Letër Këshilluese për qëllime të brendshme me qëllim të përforcimit të menaxhmentit të rrezikut.

1.2.2 Korniza e Menaxhimit të rrezikut

ICAAP-i duhet t'imarrëparasysh të gjitha rreziqet materiale, si tregues i bankës për nivelin e ekspozimit të saj ndaj këtyre rreziqeve Ky tregues i rreziqeve duhet të përfshijnë Rrezikun e Koncentrimit, Rrezikun e kontrollit / menaxhimit, Rrezikun Kreditor, Rrezikun e Normës së Interesit, Rrezikun e Likuiditetit, Rrezikun Operacional dhe Rrezikun Strategjik. Nëse një bankë është e ekspozuar ndaj rreziqeve

tjera shtesë përveç rreziqeve të cekura më lartë, atëherë banka ka për detyrë t'i përfshijë edhe ato rreziqe në ICAAP.

1.2.2.1 Rreziku i Koncentrimit

Rreziku i Koncentrimit i cili shfaqet nga koncentrimi i portfolioskreditore mund të jetë faktor i rëndësishëm, veçanërisht për bankat e vogla. Nëse një bankë vendosë të shfrytëzojë minimumin e kapitalit të kërkuar si pikë fillestare në vlerësimin e kapitalit, gjatë vlerësimit të ekspozimit të saj ndaj rrezikut të koncentrimit duhet të specifikojë se minimumi i kapitalit të kërkuar është i kalibruar nën supozimin se banka ka portfolio të diversifikuar mirë.

Kur banka vlerëson nivelin e vetëvetishëm të koncentrimit të kredive, gjithashtu duhet të ketë parasysh edhe nivelin e koncentrimit kreditor ndaj kundërpalëve individuale sektorëve ekonomikë apo zonave gjeografike. Në rastet kur biznesi i bankës, sipas natyrës, është i koncentruar (p.sh. një firmë e specializuar në kreditimin e një sektori të vetëm, apo kur ekziston koncentrim i kolateralit), banka duhet të ketë parasysh ndikimin e pafavorshëm të faktorëve ekonomikë në sektorët apo zonat e koncentruara dhe ndikimin në gjithsej cilësinë e mjeteve.

1.2.2.2 Kontrolli (Cilësia e kontrollit të ambientit të brendshëm)

Menaxhimi i Rrezikut

Kontrolli/Menaxhimi i Rrezikut mund të ndahet në rrezikun që vjen nga kontrolli/mangësitë e menaxhimit dhe në rrezikun që vjen për shkak të kufizimeve në kontroll/menaxhim të rrezikut. Mangësitë në Kontroll/Menaxhim kanë të bëjnë me rrethanat në të cilat banka nuk është në përputhshmëri me minimumin e kërkesave rregullative. Kufizimet e Kontrollit/menaxhimit lidhen me rrethanat kur bankat janë në përputhshmëri me kërkesat rregullative, mirëpo, për shkak të arsyeve strukturore të vetëvetishme në madhësinë e tyre, kanë kapacitete të kufizuara për të ndërtuar sisteme dhe kontrolla të avancuara qeverisëse. Mangësitë në Kontroll/Menaxhim zakonisht duhet të adresohen duke i shfrytëzuar instrumentet tjerë të zvogëlimit të rrezikut sesa kapitalin. Në fakt, për të adresuar këtë qështje në mënyrë më adekuate banka duhet të përpilojë një plan veprimi për të zgjidhur problemet në afat sa më të shpejtë.

Rreziku i Kontrollit / Menaxhimit për shkak të kufizimeve të Kontrollit/Menaxhimit mund të paraqesë një faktor të rëndësishëm për bankat. Duke marrë parasysh principin e proporcionalitetit, BQK nuk pret që të gjitha bankat të kenë nivel të avancuar të njëjtë sa i përket qeverisjes dhe kontrollave të brendshme. Megjithatë, pa marrë parasysh faktorët tjerë, kur merret parasysh menaxhimi proporcional dhe ambienti i kontrollit (në relacion me një rrezik specifik apo rrezikun në përgjithësi) profili i përgjithshëm i rrezikut mund të jetë më i lartë në bankat e vogla. Prandaj, nga bankat me strukturë më pak komplekse pritet që të konsiderojnë rrezikun që vjen nga kufizimet e Kontrollit/Menaxhimit në vlerësimin brendshëm të kapitalit.

1.2.2.3 Rreziku Kreditor

Kërkesat minimale të Shtyllës I kërkojnë që Rreziku Kreditor të jetë plotësisht i mbuluar. Megjithatë, qasja e standardizuar mund të mos reflektojë gjithë Rrezikun Kreditor të një banke të caktuar. Prandaj, është me rëndësi që banka të kontrollojë me kujdes të shtuar nëse Rreziku Kreditor është përfshirë plotësisht sipas kërkesave për kapital, ashtu siç përcaktohet në metodologjinë e Shtyllës I (qasja e standardizuar). Për shembull, banka duhet të sigurohet se gjatë vlerësimit të kapitalit të brendshëm gjithashtu të alokoj fonde edhe për klasat e ekspozimeve me performancë më të dobët ku standardet e kontabilitetit nuk kërkojnë (apo lejojnë) ndarje provizionesh dhe aty ku qasja sipas kërkesave të Shtyllës I nuk reflekton në mënyrë të mjaftueshme rrezikun e një portofoli të caktuar.

1.2.2.4 Rreziku i Normës së Interesit

Banka duhet të vlerësojë ndieshmërinë e pozicioneve të saja financiare ndaj lëvizjeve potenciale negative në normat e interesit. Për shembull, banka duhet të vlerësojë nëse ndieshmëria ndaj rrezikut të normave të interesit që rrjedh nga mospërputhjet e normave të interesit dhe mospërputhjet e maturiteteve në mes të aseteve dhe detyrimeve.

1.2.2.5 Rreziku i Likuiditetit

Kur banka bën vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, gjithashtu duhet të ketë parasysh ndjeshmërinë e financimit të saj, veçanërisht aftësitë e saj për të shtuar fonde shtesë në kohë të vështira ekonomike. Rrjedhimisht, banka duhet të kontrollojë nëse fondet e financimit janë të diversifikuara mjaftueshëm. Mundësia e rritjes së kapitalit të ri natyrisht varet nëse banka amë është e fortë financiarisht si dhe nëse banka është e listuar në ndonjë bursë ose jo. Filialet e bankave amë financiarisht të forta natyrisht se do ta kenë më të lehtë qasjen në fonde shtesë. Megjithatë, nëse filiala mbështetet vetëm në bankën amë në rast nevoje për fonde shtesë, atëherë banka gjithashtu duhet të marrë në konsideratë faktin se qasja në fonde shtesë papritmas mund të kufizohet në rast se rejtingu i cilësisë kreditore të bankës amë ka pësuar rënie. Prandaj, banka duhet të zhvillojë një plan kontingjent adekuat.

1.2.2.6 Rreziku Operacional

Rreziku Operacional në përgjithësi pritet të mbulohet nga kërkesat minimale të Shtyllës I (Qasja Bazike, Qasja e Standardizuar, Qasja e Avancuar). Megjithatë, mund të ekzistojnë edhe faktorë tjerë që banka duhet t'i marrë në konsideratë. Në disa raste, performanca e bankës mund të varet nga personat kyç apo nga teknologjia informative, veçanërisht në bankat më vogla. Gjatë përpilimit të analizës së ndieshmërisë, banka duhet të ketë parasysh ndikimin nga largimi i personave kyç në aftësinë e saj për të operuar dhe në të hyrat e saj. Për më tepër, banka duhet të ketë parasysh rrezikun që vjen nga teknologjia informative si nën-kategori e rrezikut operacional që është rreziku aktual apo rrezik në të ardhmen i të hyrave dhe kapitalit që rrjedh nga teknologjia informative jo adekuate dhe proceseve në aspekt të menaxhimit, ekskluzivitetit, integritetit, kontrollit dhe vazhdueshmërisë, apo që rrjedh nga politikat dhe strategjia jo-adekuate të TI-së apo nga përdorimi jo-adekuat i teknologjisë informative të bankës.

1.2.2.7 Rreziku Strategjik

Banka duhet të vlerësojë se si plani i biznesit mund të afektojë kapitalin e bankës përgjatë kohëzgjatjes së këtij plani. Banka duhet të vlerësojë impaktin në kapitalin e saj duke i dicensifikuar aktivitetet e saja si dhe rrezikun që vjen nga dështimi në

menaxhimin e linjave të reja të biznesit.

1.2.2.8 Faktorët Shtesë të Rrezikut

Bankat gjithashtu duhet të kenë parasysh ndikimin që mund të kenë faktorët e jashtëm. Megjithatë, BQK pret që ndikimi që vjen nga faktorët e jashtëm të jetë i mbuluar nga vlerësimi i duhur i: Rrezikut Kreditor, Rrezikut të Tregut, Rrezikut të Likuiditetit, Rrezikut Operacional, Rrezikut të Koncentrimit dhe Rrezikut Strategjik.

Për më tepër, një burim potencial i paqëndrueshmërisë së kapitalit mund të vijë edhe nga vetë ndërlikohjet (korrelacionet) ndërmjet dhe në kuadër të kategorive të rrezikut. Kjo për arsye se korrelacionet ndërmjet rreziqeve mund të ndryshojnë papritmas, veçanërisht në kohë krizash në tregje. Prandaj, ICAAP-i duhet të ketë parasysh edhe ndjeshmërinë dhe luhatjet e kapitalit nën supozimet e ndryshimeve të korrelacioneve.

1.2.3 Korniza e Menaxhimit të Kapitalit

Menaxhimi i kapitalit të bankës duhet të zbatohet në suaza të një platforme largpamëse/parashikuese, në mënyrë që të sigurohet se ndryshimet e mundshme në strategjinë e biznesit, ambientin operues, apo ndryshimet në faktorë të tjerë që mund të afektojnë profilin e rrezikut dhe bazën e kapitalit janë marrë në konsideratë. Gjithashtu, banka duhet të mbajë kapitaledhe për ndryshimet e papritura/paparashikuara përveç asaj që është aprovuar në strategjinë e bankës. Përveç ndryshimeve të brendshme faktorë të jashtëm që mund të kenë ndikim në bankë si rritja e lartë e kredive në ekonomi gjithashtu duhet të merren parasysh në ICAAP.

Një komponentë e rëndësishme e ICAAP-it është edhe vendosja e niveleve të synuara të kapitalit sipas standardeve të kërkuara të kapitalit duket u bazuar edhe në vlerësimet e kapitalit sipas nevojave të brendshme. Bankat duhet të vlerësojnë në mënyrë adekuate kapitalin e tyre në aspekt sasior dhe cilësor. Në linjë me detyrat menaxhuese dhe mbikëqyrëse, Trupi Menaxhues i bankës duhet në mënyrë formale të konfirmojë (në nivel të Bordit të Drejtorëve) se nivelet e kapitalit janë vendosur konform apetitit për rrezik.

Gjatë vendosjes së niveleve të kapitalit, banka duhet të ketë parasysh aspekte të caktuara si apetiti për rrezik, kërkesat rregullatore për kapital, vlerësimet e brendshme për kapital përfshirë ato që rrjedhin nga plani biznesor dhe strategjik, pritjet e luhatshmërisë së fitimeve si dhe teprica e kapitalit, politikën e alokimit të kapitalit, vlerësimet relevante nga agjencitë e rejtingut dhe mundësitë shtesë për qasje në kapital të ri. Prandaj, banka mund të përdorë qasje të ndryshme gjatë vendosjes së niveleve të kapitalit apo të implementojë stres-testet.

Modeli i kapitalit ekonomik në përgjithësi nuk kërkohet nga bankat, edhe pse bankat me koncentrim më të sofistikuar të biznesit mund të zgjedhin të përdorin modele të tilla në stres-test. Bankave u kërkohet që të përmbushin kërkesat minimale për kapital sipas gjithsej kapitalit rregullator. Mund të ndodhë shpesh që bankat të konsiderojnë mundësinë e tejkalimit të kapitalit rregullator. Prandaj, banka duhet të krijojë një përbërje/strukturë të duhur të kapitalit, në mënyrë që të sigurohet se kapitali është në gjendje të absorbojë humbjet e mundshme në çdo kohë duke i mundësuar bankës të operojë edhe në kushte stresuara (krize).

Sipas standardeve të kërkuara për kapital, bankat e rregulluara duhet të prezantojnë strategjinë për mbajtjen e niveleve e mjaftueshme të kapitalit përgjatë gjithë kohës, e cila strategji duhet të përfshijë edhe faktorët kapital-gjenerues dhe kapital-konsumues.

Këta faktorë kapitali duhet të konsiderojnë rritjen e kapitalit përmes rritjes së të hyrave dhe aftësinë e bankës në qasjen e fondeve të jashtme për kapital (në kontekst të Gjithsej Kapitalit Rregullator) dhe mundësinë e shtimit të kapitalit nga aksionarët, kompanitë e holldingut apo palët tjera. Faktorët kapital-gjenerues dhe kapital-konsumues duhet të përfshijnë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rritjes së biznesit të planifikuar, si dhe mbulesë kapitali të duhur për nevoja të menjëhershme dhe ato të projektuara nën kushte të ndryshme të tregut dhe ekonomisë brenda skenarëve të ndryshëm të stres-testit. Bankat gjithashtu duhet të përfshijnë kërkesat për kapital ekonomik, ndikimin nga vlerësimet e jashtme të rejtingut, pritjet e aksionarëve për nevoja të kapitalit apo konsideratën ndaj tregut në mënyrë që të

sigurojnë menaxhim të duhur të kapitalit.

Me qëllim të parandalimit të rënies së kapitalit nën nivelin e synuar të bankës si dhe nivelit të kërkuar nga rregullatori, bankave u kërkohet që të ndjekin standardet e kapitalit asisoji që të ndërtojnë sinjale të paralajmërimit të hershëm për menaxhmentin e lartë. Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Lartë duhet të jenë të informuar në baza të rregullta lidhur me statusin e këtyre sinjaleve në mënyrë që të rivendosin kapitalin me kohë dhe banka të vazhdojë operacionet.

Bankat përdorin masa të ndryshme në mbrojtjen e kapitalit. Për shembull, banka mund të rrisë kapitalin përmes burimeve të jashtme, ndryshimet në politikën e shpërndarjes së kapitalit apo politikën e riinvestimeve, ngadalësimin apo ndërprerjen e bizneseve të reja, shtijën e pjesshme të disa fushave të biznesit apo shitjen e asetëve si dhe përmirësimin potencial në strategjinë biznesore dhe strategjinë e investimeve. Në rast të ndërmarrjes së një aksioni të tillë për mbrojtjen e pozicionit të kapitalit bankat duhet të kenë parasysh se deri në çfarë mase do të përmirësonin pozicionin e kapitalit brenda një kornize kohore të caktuar dhe brenda një impakti të pranueshëm.

1.2.4 Dokumentimi i ICAAP-it

Për të zbatuar ICAAP-in, bankat duhet të aranzhojnë një spektër procesesh dhe sistemesh për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit përkitazi me profilin individual të rrezikut. Profili i rrezikut të bankës duhet të mbulojë dhe dokumentojë kapacitetin e kapitalit të synuar, projektimin dhe monitorimin e pozicioneve të kapitalit, apo nivelin e përcaktuar të kapitalit. Bankat duhet t'i raportojnë rezultatet sipas proceseve të standardizuara përmes dokumenteve procedurale dhe politikave të ndryshme, për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e Lartë. Ky dokumentim, i cili duhet të sigurohet nga bankat, mund të përfshijë kërkesat standarde për kapital në lidhje me Procesin e Brendshëm për Vlerësimin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit në formë të një raporti ICAAP dhe një deklaratë përmbledhëse.

1.3 Dizajnimi i ICAAP-it

Secila bankë duhet të marrë përgjegjësinë e dizajnit të ICAAP-it, zbatimit dhe zhvillimit në mënyrë individuale. Dizajnimi, zbatimi dhe zhvillimi duhet të

specifikohen dhe dokumentohen në mënyrë të plotë në politiken e kapitalit. Për të paraqitur gjendjen aktuale të institucionit të vet, bankës i kërkohet që të sqarojë nevojat dhe synimet e vlerësuara dhe pritet prej saj që të paraqesë një analizë të mangësive (angl. Gap analysis; synimet krahas nevojave) dhe të planifikojë ose pregatisë në mënyrë të kujdesshme një plan të zbatimit hap pas hapi.

1.4 Metodologjia

Nuk ka një proces të vetëm që mund të quhet si i saktë apo i drejtë për ndërtimin e ICAAP-it. Për shembull, banka mund të adoptojë një ICAAP të bazuar në kërkesat minimale për kapital sipas Shtyllës I dhe të vlerësojë se a ka nevojë për kapital shtesë në proporcion me rrezikun që nuk i takon Shtyllës I. Përndryshe, bankat gjithashtu mund të zgjedhin të adoptojnë një qasje bllok, duke përdorur metodologji të ndryshme për rreziqe të ndryshme sipas Shtyllave të ndryshme dhe pastaj të përlllogarisin shumën e kapitalit të nevojshëm. Si një alternativë tjetër, banka mund të fillojë me nivelin e kapitalit aktual (kapacitetin absorbues të rrezikut) dhe të zërthejë më tutje në nën-kategori të gjitha rreziqet materiale. Metodologjia e zgjedhur duhet të përkohet me aftësinë e bankës për të mbledhur informacionet e nevojshme dhe të përlllogarisë dhe vlerësojë inputet e nevojshme në mënyrë të besueshme.

Pavarësisht metodologjisë që banka vendosë të miratojë, banka gjithashtu duhet të krahasojë kapitalin e tanishëm dhe kapitalin e ardhshëm me nevojat e tanishme dhe ato në të ardhmen të kapitalit të brendshëm që rezultojnë ngavlerësimet e brendshme. Përlllogaritja e tanishme dhe shpërndarja e kapitalit të brendshëm gjithmonë duhet të plotësohet me procedura cilësore, masa dhe provizione që identifikojnë, menaxhojnë, kontrollojnë dhe monitorojnë të gjitha rreziqet.

1.4.1 Qasja e Kërkesave për Kapital sipas Shtyllës I

Banka që zgjedhë si pikënisje kërkesat minimale të kapitalit sipas Shtyllës I, duhet gjithashtu të ketë parasysh se mund t'i kërkohet kapital shtesë për rreziqet që nuk i takojnë apo nuk mbulohen plotësisht sipas kërkesave të Shtyllës I. Së pari kërkohet që banka të vlerësojë nëse kërkesat minimale të kapitalit sipas Shtyllës I mbulojnë plotësisht rreziqet e Shtyllës I (Rrezikun Kreditor, të Tregut dhe Operacional), dhe së

dyti, banka duhet të vlerësojë sa kapital i kërkohet të alokojë për rreziqet e Shtyllës II dhe faktorëve tjerë të jashtëm.

1.4.2 Qasja e strukturuar

Banka që vendosë të përdorë qasjen e strukturuar duhet që fillimisht të vendosë kapitalin fillestar në zero dhe pastaj të shtoj kapital sipas rreziqeve të përcaktuara në Shtyllën I, Shtyllën II dhe rreziqeve tjera shtesë. Kjo metodologji mund të merret si një model i thjeshtë për llogaritjen e kapitalit ekonomik dhe nuk bazohet në kërkesat minimale për kapital të Shtyllës I. Njëherazi, banka gjithashtu duhet të llogarisë kapitalin rregulator sipas Shtyllës I, mirëpo ky kalkulim nuk do të përdorej për nevoja të ICAAP-it. Në këtë rast, të gjitha fushat e rrezikut, përfshirë këtu Rrezikun Kreditor, Rrezikun e Tregut dhe Rrezikun Operacional duhet të vlerësohen dhe të merren në konsideratë të veçantë gjatë vlerësimit të brendshëm të kapitalit. Si pikë fillestare mund të përdoret analiza e ndjeshmërisë. Analiza e ndjeshmërisë duhet të bazohet në skenar të supozuar, mirëpo të besueshëm. Rreziqet që nuk janë marrë parasysh në analizën e ndjeshmërisë, duhet të merren parasysh edhe në qasjen e strukturuar.

1.4.3 Shpërndarja e kapitalit

Banka që vendosë të përdorë këtë metodë duhet të fillojë nga kapitali aktual (kapaciteti absorbues i rrezikut) dhe të krahasojë vlerën e tij me gjithsej rreziqet. Prandaj, kërkohet që kapitali të (nën)ndahet për secilin rrezik material. Ky hap kërkon kuantifikimin, apo të paktën metodën vlerësuese për rreziqe të ndryshme. Shuma e kapitalit të ndarë për secilën kategori të rrezikut përcaktohet nga vlera e tashme dhe ajo në të ardhmen e rrezikut për secilën kategori, nga rezerva mbështetëse e rrezikut të mundshëm (ang. Risk buffer) dhe apetiti i institucionit për rrezik. Institucioni vendosë vetë se cila metodë e kuantifikimit /vlerësimit të rrezikut është më e përshtatshme dhe e mjaftueshme për bankën. Po që se kapitali i ndarë duket të jetë i pamjaftueshëm, atëherë banka duhet të zvogëlojë rrezikun ose të rrisë kapitalin. Shumat e ndara të kapitalit, do të shërbejnë kështu si një sistem limitues, të cilat do të asistojnë dhe lehtësojnë balancimin e kapacitetit absorbues të rrezikut dhe rreziqeve të institucionit. Llogaritja aktuale e kapitalit dhe shpërndarja e kapitalit gjithnjë duhet të

plotësohet me procedura mjaft cilësore, masa dhe procedura identifikimi, menaxhimi, kontrolli dhe monitorimi rreziqesh.

2. Principet Bazë të ICAAP-it

Objektivi kryesor i ICAAP-it qëndron në përmirësimin e relacionit mes profilit të rrezikut të bankës, menaxhimit të rrezikut dhe kapitalit të mbajtur. ICAAP-i përfaqëson një proces, i cili siguron se banka identifikon në mënyrë adekuate, matë, agregon dhe monitoron rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar si dhe mbanë nivele adekuate të kapitalit të brendshëm përkitazi me profilin e rrezikut dhe themelon sisteme të menaxhimit të rrezikut dhe i zhvillon edhe më tutje ato në baza të rregullta.

Zbatimi i ICAAP-it duhet të bazohet në principet në vijim, të përcaktuara nga Standardet e Bazel-it për Kapital në Shtyllën II dhe të publikuara nga Autoriteti bankar Europian (EBA) që është institucioni pasardhës i Komitetit Europian të Mbikëqyrjes Bankare (CEBS):

ICAAP 1: Secila bankë duhet të ketë një proces për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit krahas profilit të rrezikut të saj (një ICAAP).

Secila bankë duhet të kryejë procesin e ICAAP-it në baza vjetore dhe ta dokumentojë atë në mënyrë të duhur.

ICAAP 2: Përpilimi i ICAAP-it është përgjegjësi e institucionit.

a. Secili institucion është përgjegjës për përpilimin e ICAAP-it të tij dhe për caktimin e niveleve të brendshme të kapitalit, të cilat janë konsistente me profilin e rrezikut dhe ambientin operues. ICAAP-i duhet të ndërtohet sipas nevojave dhe rrethanave të institucionit dhe duhet të përdorë inputet dhe definicionet që institucioni zakonisht përdorë për nevoja të brendshme.

b. në të njëjtën kohë, institucioni duhet të demonstrojë se në çfarë mënyre ICAAP-i përmbushë kërkesat mbikëqyrëse.

c. Institucionet përkatëse mbajnë përgjegjësi të plotë për ICAAP-in e tyre, pavarësisht faktit se mund të jetë i përpiluar (kontraktuar) edhe nga palët e jashtme, dhe institucioni duhet të kuptojë që kontraktimi i jashtëm nuk e liron institucionin nga

nevoja për t'u siguruar se ICAAP-i i tyre reflekton plotësisht situatën e tyre specifike dhe profilin individual të rrezikut.

ICAAP 3: ICAAP-it duhet të dizajnohet në mënyrë që të jetë plotësisht i specifikuar, dokumentuar dhe se trupi menaxhues (me funksione mbikëqyrëse dhe menaxhuese) duhet të marrë përgjegjësi për të.

- a. Përgjegjësia për nisjen dhe dizajnimin e ICAAP-it i takon trupit menaxhues (me funksione mbikëqyrëse dhe menaxhuese). Funksionet mbikëqyrëse të trupit menaxhues duhet të aprovojnë dizajnin konceptual (të paktën, fushëveprimin, metodologjinë e përgjithshme dhe objektivat) të ICAAP-it. Detajet e dizajnit (p.sh. detajet teknike) janë përgjegjësi e dedikuar ndaj funksioneve menaxheriale.
- b. Trupi menaxhues (me funksione mbikëqyrëse dhe menaxhuese) gjithashtu është përgjegjës për integrimin e planifikimit të kapitalit dhe menaxhimit të kapitalit brenda kulturës dhe qasjes së përgjithshme menaxheriale. Trupi menaxhues duhet të sigurohet se planifikimi i kapitalit dhe politikat menaxhuese janë komunikuar dhe zbatuar në tërë institucionin si dhe janë mbështetur me resurse të nevojshme.
- c. ICAAP-i i institucionit (si metodologjia, supozimet dhe procedurat) dhe politikat rreth kapitalit duhet të dokumentohen në mënyrë që të rishikohen dhe aprovohen në nivel të lartë (trupi menaxhues me dy funksionet e tij).
- d. Rezultatet e ICAAP-it duhet të raportohen tek trupi menaxhues (me funksione mbikëqyrëse dhe menaxhuese).

ICAAP 4: ICAAP-i duhet jetë pjesë integrale e procesit menaxhues dhe kulturës vendimmarrëse të institucionit.

- a. ICAAP-i duhet të jetë pjesë integrale e proceseve menaxhuese në mënyrë që t'ia mundësojë trupit menaxhues (me funksione mbikëqyrëse dhe menaxhuese) të vlerësojë, në baza të rregullta, rreziqet që janë të vetëvetishme në aktivitetet e institucionit dhe materiale për institucionin. Kjo mund të mundësohet përmes përdorimit të ICAAP-it për shpërndarje të kapitalit ndaj njësive biznesore, deri te përdorimi i tij në vendimet rreth procesit kreditues dhe deri te roli i tij në marrjen e vendimeve të përgjithshme biznesore (p.sh. planet e zgjerimit) dhe buxhetimit.

ICAAP 5: ICAAP-i duhet të rishikohet në baza të rregullta

- a. Institucioni duhet të rishikojë ICAAP-in aq shpesh sa është e nevojshme që të sigurojë se rreziqet janë të mbuluara në mënyrë adekuate dhe se mbulesa me kapital reflekton profilin e rrezikut të institucionit. Rishikimi i ICAAP-it duhet të bëhet të paktën në baza vjetore.
- b. ICAAP-i dhe procesi rishikues i tij duhet të jetë subjekt i një rishikimi të pavarur, të brendshëm dhe rishikimit të mundshëm të jashtëm.
- c. Çdo ndryshim në fokusin strategjik të institucionit, planit biznesor, ambientit operues, apo faktorëve tjerë që materialisht mund të afektojnë supozimet apo metodologjinë e përdorur në ICAAP duhet të përshtaten në mënyrë të duhur edhe në ICAAP. Gjithashtu, rreziqet e reja në biznesin e institucionit duhet të identifikohen dhe përfshihen në ICAAP.

ICAAP 6: ICAAP-i duhet të jetë i bazuar në rrezik

- a. Mjaftueshmëria e kapitalit të institucionit është funksion i aranzhimit adekuat të profilit të rrezikut. Prandaj, institucioni duhet të vendosë nivele të kapitalit që janë konsistent me profilin e rrezikut dhe ambientin operues.
- b. Institucionet mund të konsiderojnë edhe faktorë tjerë gjatë përcaktimit se sa kapital duhet të mbajnë, të tilla si, vlerësimet nga agjencitë e jashtme për vlerësime kreditore, reputacionit në treg dhe objektivat strategjike.
- c. Megjithatë, nëse konsideratat tjera janë përfshirë në këtë proces, institucioni duhet të tregojë gjatë dialogut më mbikëqyrësin e saj se si kanë ndikuar këto nëvendimin e marrur për shumën e kapitalit të mbajtur.
- d. Ekzistojnë disa lloje rreziqesh (me më pak mundësi për t'u kuantifikuar), për të cilat vlerësimi i menaxhimit dhe zvogëlimit të rrezikut në ICAAP duhet të jetë më shumë i natyrës cilësore. Institucioni duhet të dëshmojë në mënyrë të qartë se për cilin rrezik janë ndërmarrë masa sasiore, si dhe për cilat rreziqe ndërmarrja e masave cilësore paraqet mjetin e duhur për zvogëlimin e rrezikut.
- e. Institucionet që zgjedhin Shtyllën I si pikënisje për përpilimin e ICAAP-it të tyre (shih më poshtë) gjithashtu mund të konsiderojnë zhvillimin e një qasje të plotësisht të bazuar në rrezik, pasi që Standardet për Kërkesat e Kapitalit promovojnë qasje të bazuar në rrezik (përfshirë Qasjen e Standardizuar për Rrezikun Kreditor), meqë

menaxhmenti i përgjithshëm pret që korniza e kontrollit të fokusohet në masë të madhe në qasje të bazuar në rrezik.

ICAAP 7: ICAAP-i duhet të jetë gjithpërfshirës

a. ICAAP-i duhet të përfshijë të gjithë rreziqet materiale ndaj të cilave është i ekspozuar institucioni, përkundër faktit se nuk ekziston një kategorizim i standardizuar të llojeve të rreziqeve dhe definimit të materialitetit. Institucioni është i lirë në përdorimin e definicioneve dhe terminologjisë së vet, megjithatë duhet t'i shpjegojë ato në detaje të mbikëqyrësi, përfshirë këtu edhe metodat e përdorura, mbulueshmërinë e rreziqeve materiale si dhe të tregojë se si qasja e institucionit lidhet me obligimet që dalin nga Shtylla I (p.sh. nëse për qëllime të ICAAP-it institucioni përdorë definicionin e Rrezikut Operacional ndryshe nga definicioni i Shtyllës I, apo nëse definicioni i Rrezikut të Normës së Interesit përfshinë edhe rrezikun në librin e bankës edhe rrezikun në librin e tregtueshëm).

b. ICAAP-i duhet të mbulojë të gjitha rreziqet materiale të Shtyllës II ndaj të cilave institucioni mund të jetë i ekspozuar, si Rreziku nga Norma e Interesit në librin e bankës, Rrezikun e Koncentrimit, Rrezikun e Likuiditetit, Rrezikun Strategjik dhe të Reputacionit. Disa nga këto rreziqe kanë më pak të ngjarë të shfaqin nevojën për qasjen sasiore, prandaj në këto raste pritjet që institucioni të përdorë vlerësime dhe metoda cilësore për zvogëlimin e rrezikut.

Për më tepër, faktorët e jashtëm të rrezikut ndaj institucionit gjithashtu duhet të adresohen. Rreziqe të tilla mund të lindin nga ambienti rregullator, ekonomik e biznesor, e të cilat nuk janë të përfshira në listen e rreziqeve të përmendura më lartë.

ICAAP 8: ICAAP-i duhet të jetë parashikues

a. ICAAP-i duhet të ketë parasysh planet strategjike të institucionit dhe si ato lidhen me faktorët makroekonomikë. Institucioni duhet të zhvillojë strategji të brendshme për mirëmbajtjen e niveleve të mjaftueshme të kapitalit, e cila inkorporon faktorë tjerë si pritjet për rritjen e kredive, burimet e ardhshme të fondeve dhe përdorimi i këtyre fondeve në të ardhmën, politika e përdorur për dividendë, si dhe luhatjen prociklike të fondeve minimale të kërkuara nga

sipas Shtyllës I.

- b. Institucioni duhet të ketë plan të qartë dhe të aprovuar të kapitalit, i cili shprehë objektivat e institucionit si dhe periudhen e nevojshme për arritjen e atyre objektiveve. Procesi i planifikimi të kapitalit dhe përgjegjësitë duhet të nënvizohen në këtë plan në pika të trasha. Plani gjithashtu duhet të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit në të ardhmen, me cdo pengese eventuale ndaj kapitalit, dhe një plan kontigjent të përgjithshëm për përballje me ngjarje të paparashikuara dhe devijuese (p.sh. nevoja për rritje të kapitalit, kufizimet biznesore apo përdorimi i teknikave për zvogëlimin e rrezikut).
- c. Institucionet duhet të zbatojnë stress-teste adekuate, të cilat marrin parasysh, për shembull, rreziqet nëjuridiksionin/et përkatës/e në të cilin ato operojnë si dhe një fazë të caktuar të ciklit të biznesit. Institucionet duhet të analizojnë impaktin e legjislacionit të ri, veprimet e konkurrentëve dhe faktorë tjerë që mund të kenë ndikim në performancën e tyre, në mënyrë që të përcaktojnë se cilat kushte mund t'i përballojnë.

ICAAP 9: ICAAP-i duhet të bazohet në masa dhe procese adekuate vlerësuese

- a. Institucionet duhet të kenë një proces të dokumentuar për vlerësimin e rreziqeve. Ky proces i instaluar dhe aprovuar mund të operojë ose në nivel të institucionit përkatës, ose në nivel grupi.
- b. Rezultatet dhe gjetjet e ICAAP-it duhet të futen në strategjinë e evaluimit dhe apetitin për rrezik të institucionit. Në rastin e institucioneve më pak të sofistikuar, ku planifikimi i sigurtë i kapitalit duket të jetë më i vështirë, rezultatet e ICAAP-it kryesisht duhet të reflektojnë mënyrën e menaxhimit të profilit të rrezikut të institucionit (p.sh. përmes ndryshimit në procesin e kreditimit apo përmes mënyrës së shfrytëzimit të teknikave për zvogëlimin e rrezikut).
- c. Përdorimi i modelit formal të kapitalit ekonomik (ose ndojë tjetër) nuk do t'u kërkohet institucioneve, edhe pse kjo pritet nga institucionet më të sofistikuar.
- d. Nuk ekziston vetëm një proces i caktuar dhe korrekt. Duke marrë parasysh principin e proporcionalitetit të institucionit dhe praktikat zhvillimore përgjatë kohës, institucionet mund të dizajnojnë ICAAP-et e tyre në mënyra të ndryshme. Për shembull, ICAAP-i mund të përdorë rezultatet e dala nga metodologjia e Shtyllës I (të

cilat në vetëvetë janë po ashtu të bazuara në rrezik) dhe të konsiderojnë elementet tjera që nuk i takojnë Shtyllës I. Me fjalë tjera, me qëllim të arritjes së kapitalit të synuar, institucionet duhet që së pari të marrin në konsideratë kërkesat nga Shtylla I dhe pastaj të vlerësojnë konceptet e Shtyllës II që ndërlidhen me ato të Shtyllës I (si rreziku i koncentrimin, Rreziku Rezidual nga Teknikat e Zvogëlimit të Rrezikut dhe Sekjurizimit) dhe konceptet që nuk trajtohen nën Shtyllën I (sic është Rreziku i Normës së Interesit). Vlerësimi i kapitalit sipas Shtyllës I mund të duket si qasje adekuate për disa institucione, mirëpo në këtë rast institucionet duhet të arsyetojnë në mënyrë aktive këtë zgjedhje, përfshirë këtu edhe elementet parashikuese. Mbikëqyrësit presin nga institucioni që të demonstrojë stë gjitha rreziqet jashtë Shtyllës I dhe ka gjetur edhe ato reziqe që mungojnë aty, që nuk janë materiale apo të mbuluara mbi minimumin e kërkuar sipas Shtyllës I. Banka duhet të përdorë një qasje të 'strukturuar', përmes përdorimit të metodologjive të ndryshme për mbulimin e rreziqeve të ndryshme (rreziqet në Shtyllën I dhe Shtyllën II) dhe pastaj të përlogarisë rezultatin e shumës së thjeshtë të kërkesave për kapital. Një sistem më i sofistikuar dhe kompleks mund të përdoret nga bankat, që kërkon përdorimin e qasjes 'bottom-up' të bazuar në transaksione, e cila qasje ka të integruara edhe korrelacionet mes rreziqeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, bankat mund të vërejnë se disa rreziqe maten më lehtë se rreziqet tjera, varësisht nga informacioni në dispozicion. Kjo nënkuton se ICAAP-i mund të jetë kombinim i llogaritjeve të kombinuara dhe vlerësimeve.

f. Është me rëndësi që institucionet që mos mbështeten vetëm në metoda sasiore për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, por gjithashtu të përfshijnë edhe elementin cilësor të vlerësimit dhe vlerësimet e menaxhmentit rreth inputeve dhe outputeve. Rejtingu i jashtëm i synuar, reputacioni i institucionit në treg dhe objektivat strategjike gjithashtu duhet të konsiderohen gjatë përdorimit të tri metodologjive.

g. Rreziqet të cilat nuk janë të matshme por janë materiale duhet të përfshihen, mirëpo duhet përfshirë edhe rreziqet e tilla të cilat mund të vlerësohen si materiale. Kjo kërkesë mund të lehtësohet nëse institucioni demonstroi se posedon politika adekuate për zvogëlimin/menaxhimin e këtyre rreziqeve.

ICAAP 10: ICAAP-i duhet të gjenerojë rezultate të arsyeshme.

a. ICAAP-i duhet të gjenerojë një vlerësim dhe shumë kapitali të arsyeshme. Institucioni duhet të jetë në gjendje të shpjegojë ngjashmëritë dhe dallimet midis ICAAP-it të tij (i cili duhet të mbulojë të gjitha rreziqet materiale) dhe kërkesave të veta të financimit, derisa mbikëqyrësi të jetë i kënaqur me përgjigjen e dhenë. b. Institucionet mund të inkurajohen që të shpalosin më shumë informacion që nuk është konfidencial apo në pronësi. Kjo qasje mund të iu sigurojë institucioneve mjetet për krahasimin e ICAAP-it të tyre me ICAAP-in e peer grupit, për nevoja të brendshme.

3. Roli i BQK-së

Roli i BQK-së qëndron në rishikimin e ICAAP-it të pranuar nga institucionet në Procesin Rishikues të Mbikëqyrjes. Prandaj, BQK-së i takon e drejta e rishikimit të ICAAP-it të një banke në çdo kohë, e cila përfshinë të drejtën e kryerjes së ekzaminimeve në vend apo ndonjë mase tjetër mbikëqyrëse që BQK e sheh të arsyeshme varësisht nga rrethanat, brenda fuqisë dhe përgjegjësisë ligjore.